

FJALA E DEPUTETES GRETA BARDELI

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

Të nderuar bashkëqytetarë,

Ky projektligj, që na u ofrua për diskutim dhe votim, patjetër që gjeti mbështetjen me votë të opozitës, por në të njëjtën kohë na lejon të hyjmë në thelbin e problemit. Kjo çështje, pa diskutim e kërkuar nga pala britanike, hap një debat të thellë për atë që ne të gjithë si shoqëri shqiptare e shikojmë sot, por edhe mbarë Europa, pamjet e rënda që kanë zënë hapësirë në lajmet kryesore të mediave franceze dhe atyre britanike. Kurrë më parë nuk e kishim menduar që sot, në vitin 2022, do të shikonim një dramë të vërtetë njerëzore të shqiptarëve në brigjet e Francës dhe të Anglisë, ndërkohë që qeveria rendit dhe proklamon sukseset e saj të pafundme.

Raportet e fundit të qeverisë britanike japin të dhëna të frikshme për sa u përket në veçanti të miturve që janë pjesë e trafikut klandestin. Sipas tyre, të miturit, pasi largohen nga sistemi social, janë të ekspozuar si viktimat të shfrytëzimit të grupeve kriminale. Si e komenton kjo qeveri faktin që institucione serioze të Britanisë së Madhe pyesin pse një numër kaq i lartë i emigrantëve nga Shqipëria lënë vendin e tyre dhe vijnë në brigjet e Anglisë, ndërkohë që vendi i tyre është në kohë paqeje? Si ka mundësi që numri i bashkatdhetarëve tanë është njësoj apo herë pas here më i lartë se i atyre nga vende që janë sot në luftë?

Disa vite më parë, senatorët francezë këtu në Tiranë, ngritën po të njëjtin shqetësim dhe ia ngritën po kësaj qeverie: rritja dramatike e migracionit nga vendi ynë përbente një problem shqetësues për ta. As ata nuk e kuptonin sesi shqiptarët ishin në numër gati njësoj me refugjatët që vinin nga zonat e luftës së Lindjes së Mesme. Por ministrat tanë mbyllin sytë, apo bëjnë sikur nuk duan ta kuptojnë realitetin. Këtë shuplakë po ia japin përditë qytetarët e Shqipërisë, të cilët po e braktisin vendin e tyre, dhe që çdo ditë e më tepër po i thonë “jo”, kësaj qeverie cinike, arrogante, të korruptuar dhe të lidhur këmbë e krye me krimin. Çfarë bën Ministria e Brendshme?

Grupet kriminale bëjnë kërdrinë brenda vendit, ndërsa në mes të Europës dhe Britanisë së Madhe grupet e gangsterëve shqiptarë janë kthyer në problem serioz për institucionet ligjzbatuese atje. U drejtohem sot të gjithë bashkëqytetarëve të mi të Shkodrës: të gjithë ju e dini fort mirë shkakun e largimit të shkodranëve, të familjarëve tanë, të gjithë ne i dimë arsyet pse kryeqendra e Veriut vuan nga mungesa e shpresës, të cilat janë: papunësia, varfëria, mungesa e investimeve, listat e borxheve për ushqim bazë, korrupsioni dramatik apo edhe kontrolli i territorit nga bandat. Shifrat e frikshme të largimit të banorëve të qarkut Shkodër shkojnë deri në 25%.

Dhe Shkodra me dhimbje vazhdon të renditet në vendin e parë për shpopullimin nga regjimi i Edi Ramës. Ndërkohë, sikurse ju kam thënë dhe më parë nga kjo foltore, në pikat kufitare me Malin e Zi çdo fillim jave vazhdojnë dyndjet e punëtorëve me mëditje nga Veriu, që shkojnë për të punuar në vendin fqinj, jo vetëm se atje gjejnë punë, por se paguhen edhe shumë herë më mirë se këtu në Shqipëri. Por situatën më të rëndë të këtij shpopullimi e reflekton arsimiti. Sot në bankat e shkollave dhe të universiteteve mungojnë rreth 10 mijë nxënës dhe studentë, ndërsa qeveria mbyll dyert e Pallatit të Kongresit pikërisht ditën e parë të shkollës me drejtues dhe mësues të shkollave të ndryshme të Shqipërisë, të cilët, në fakt, duhet të ishin në krye të detyrës, pranë institucioneve që drejtojnë.

Të nderuar qytetarë, të gjithë jetojmë në vendin ku Kryeministri flet plot gaz dhe hare për hapjen e lokaleve të basteve, plot optimizëm për instalacionin 4 milionë eurosh në oborrin e pushtetit, për pagesat e inceneratorëve, kur bosët e tyre janë ende në kërkim dhe hajdutët nëpër zyra. Këto fakte janë tashmë të denoncuara nga opozita dhe kjo situatë kërkon patjetër një reflektim. Për ta mbyllur, siç thonë andej nga Shkodra: “S’ka ujë Drini, që lan mëkatet tuaja”.